



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 368/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, për shkak se e kanë vendosur posterin e kandidatit për Asamble Komunale në shenjë të komunikacionit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës dega në Mitrovicë.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 29.10.2013, nga Partia Demokratike e Kosovës në të cilën thekson se aktivistë të AKR- së në Mitrovicë e kanë vendosur posterin e kandidatit për Asamble Komunale Z.Bekim Muja në shenjë të komunikacionit dhe se me këtë kanë bërë shkelje ligjore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës, nuk qëndron pasi që pretendimet ankimore janë në kundërshtim me provat e bashkangjitura në ankesë, sepse pretendohet se kandidati për Asamble Komunale është i subjektit politik AKR, ndërsa nga fotografia e ofruar si provë del se kandidati në fjalë është nga radhët e subjektit politik LDK e jo si pretendohet në ankesë, andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 368/2013 më datën 01.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

  
\_\_\_\_\_



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*